



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORE

2008  
Nr. \_\_\_ Prot

Vlorë më 29.09.2025

VENDIM

Nr. 14 datë 23.09.2025

**“PËR MIRATIMIN E PJESMARRJES SË KËSHILLIT TË QARKUT VLORE NË  
PROJEKTIN TRANSPORT.SAFER PJESË E PROGRAMIT INTERREG GREECE-  
ALBANIA 2021-2027”**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligj Nr. 65/2022 datë 15.9.2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes Financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të Asistencës Financiare të Be-së për Republikën e Shqipërisë në Kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA), Ligj 75/2024 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Republikës Helene dhe Komisionit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar (INTERREG IV-A) IPA Greqi-Shqipëri 2021–2027”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023 për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësisë dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III) pikës f të nenit 11 të Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë, Nr.13, datë 09.07.2024 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për funksionimin e Administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë”, miratuar me VKQ Nr. 12, datë 22.06.2020, Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë, Nr.7, datë 26.03.2024 “Për autorizimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë të nënshkruajë formatet e aplikimit, marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe çdo dokument tjetër për aplikimet në thirrjet e hapura të projekteve me partnerë të huaj”, Marrëveshjes së Partneritetit për projektin “TRANSPORT.SAFER” “Përmirësimi i transportit multimodal dhe i sigurisë rrugore në zonën ndërkufitare” protokolluar me tonën me Nr.1475 Prot datë 21.07.2025.

**VENDOS:**

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Këshillit të Qarkut Vlorë në projektin “TRANSPORT.SAFER” “Përmirësimi i transportit multimodal dhe i sigurisë rrugore në zonën ndërkufitare” (Upgrading multimodal transport and road safety in cross border area) në partneritet me Rajonin e Epirit (Janinë-Greqi) si Partner Lider dhe me një buxhet total të projektit prej **1,443,438.30. €**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

2. Vlera e buxhetit për Këshillin e Qarkut Vlorë është **610 272.20 €**. Vlera e bashkëfinancimit në zbatimin e projektit, si kontribut i institucionit është në masën 20% vlerë që ngarkon buxhetin e Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e gjithë administrata e Këshillit të Qarkut Vlorë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas pikës 3, neni 78 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.



*Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shpresë Nr. \_\_\_\_ Prot, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2025*

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Pallati I Kulturës “Labëria”, Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site: [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
Tel: +35533421608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Projekti **TRANSPORT.SAF.ER** "Përmirësimi i transportit multimodal dhe i sigurisë rrugore në zonën ndërkufitare" (Upgrading multimodal transport and road safety in cross border area).

Projekti **TRANSPORT.SAF.ER** ka për qëllim rritjen e sigurisë rrugore, përmirësimin e qarkullimit dhe shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë. Investimet në infrastrukturë të këtij projekti synojnë të lehtësojnë qarkullimin, të rrisin sigurinë rrugore, të ulin kohën e udhëtimit dhe të forcojnë lidhjet ndërkufitare, duke ndihmuar njëkohësisht në zhvillimin ekonomik dhe turistik të rajonit. Me Partner Lider Rajonin e Epirit (Janinë-Greqi) dhe partnerë, Rajonin e Ishujve Jonian (Korfuz-Greqi), Këshillin e Qarkut Vlorë Shqipëri ky projekt ka një buxhet total prej **1,443,438.30. €**.

Përveç investimeve infrastrukturore, projekti parashikon edhe shkëmbim njohurish, përvojash ndërmjet partnerëve, me fokus praktikat më të mira në fushën e sigurisë rrugore.

Projekti pritet të sjellë:

- përmirësim të lëvizshmërisë rajonale dhe reduktim të kohës së udhëtimit,
- infrastrukturë rrugore më të sigurt dhe më efektive,
- ndikim më të ulët në mjedis,
- rritje të kapaciteteve institucionale përmes shkëmbimit ndërkufitar të eksperiencave dhe praktikave më të mira në fushën e sigurisë rrugore.

Këshilli i Qarkut Vlorë është partner i drejtpërdrejtë në këtë projekt dhe luan një rol të rëndësishëm në:

- *koordinimit institucional në nivel rajonal.*
- ndjekjen dhe mbështetjen e ndërhyrjes infrastrukturore për rrugën *Xarrë-Kalfivua në* Konispol promovimin e rezultateve të projektit dhe shkëmbimin e përvojave me partnerët grekë,

Projekti "TRANSPORT.SAFER" përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Greqi dhe në modernizimin e infrastrukturës së transportit, duke i dhënë prioritet sigurisë rrugore dhe zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site: [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
Tel: +35533421608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

**Ylda Lamaj**

Specialist për Arsimet, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve

**Palush Naci**

Specialist për Shërbimet, Transportin dhe Emergjencat Civile

**Mauricio Pashaj**

Specialist Finance për zbatimin e buxhetit